

VENDIM
Nr. 1, datë 10.1.2013

**PËR MIRATIMIN E GARANCISË QEVERTARE, TË LËSHUAR NË FAVOR TË INTESA
SANPAOLO SHA, ALBANIA, NË KUADËR TË KONTRATËS PËRKATËSE, NDËRMJET
KËSAJ BANKE DHE KESH, SHA-SË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 57 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 3 të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit e Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e garancisë qeveritare, të lëshuar në favor të Intesa Sanpaolo, sh.a., Albania, në kuadër të kontratës së huas, ndërmjet kësaj banke dhe KESH, sh.a., për shumën 4 200 000 000 (katër miliardë e dyqind milionë) lekë.

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha